



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ prot.

Datë ____/____/ 2018

V E N D I M

Nr. 43 , Datë 07 / 02 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr. Regj.37, datë 21.06.2017, të znj.E. G, kundër Bibliotekës Kombëtare Tiranë, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “*bindjeve politike*”, “*bindjeve filozofike*”, “*gjendjes shoqërore*”, “*gjendjes martesore*”, “*gjendjes shëndetësore*” dhe “*çdo shkak tjetër*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, E. G ka filluar punë pranë Bibliotekës Kombëtare me detyrë Përgjegjëse e Përkohshme e Sektorit të Financës me datë 3 Janar 2001. Me shkresën nr.20 prot. datë 26.04.2001, është emëruar Përgjegjëse e Sektorit të Financës. Me shkresën nr.86/2 i prot., datë 22.08.2007, znj.G është emëruar Përgjegjëse e Sektorit të Agjencisë Kombëtare të Numrave Ndërkombëtare të Standartizuar (ISBN, ISSN, ISMN etj). Me shkresën nr.69/1 prot., datë 01.04.2014, (në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit nr.139, datë 28.03.2014 "Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Bibliotekës Kombëtare"), nga pozicioni i "Përgjegjësit" kategoria III-b emërtohet "Specialist", kategoria IV-a. Me Urdhërin nr.132 prot., datë 15.02.2017 znj.E. G lirohet nga detyra "Specialist i ISBN-së" në Sektorin e Agjencisë Kombëtare të Numrave Ndërkombëtare të Standartizuar (ISBN . ISSN. ISMN etj.)¹ dhe emërohet në detyrën "Klasifikatore", pranë Sektorit të Katalogimit Retrospektiv.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Sektori i ISBN-së.

Ankuesja znj.G nëpërmjet shkresës “Ankim administrativ”, datë 20.02.2017, (nr.149 prot. datë 20.02.2017), ka kërkuar anulimin e Urdhërit nr.132 prot, datë 15.02.2017 "Për emërimin në detyrë". Biblioteka Kombëtare, nëpërmjet shkresës "Kthim përgjigje ankese" me nr.61 prot. datë 28.02.2017, ka argumentuar se Urdhëri nr.132 prot. datë 15.02.2017 "Për emërimin në detyrë" është nxjerrë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe si i tillë ai duhet të lihet në fuqi. Kontrata e punës për këtë vend pune është me afat të pacaktuar.

Qysh nga viti 2001, vit në të cilin ankuesja ka lidhur marrëdhëniet e punës me Bibliotekën Kombëtare, referencat për punën e saj kanë qenë shumë të mira. Në lidhje me punën si "përgjegjëse" apo si "specialiste" e Agjencisë Kombëtare të ISBN, vlerësimet dhe referencat nga ana e botuesve kombëtare dhe nga ana e Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së, kanë qenë me vlerësim maksimal për të. Lidhur me këtë ka një sërë referencash nga botuesit kombëtarë, të cilat janë sjellë në cilësinë e provës shkresore në dosjen e saj pranë KMD-së. Ankuesja shprehet se, si rezultat i punës dhe përkushtimit të saj në këtë detyrë, u arrit mbajtja e Mbledhjes së Parë Vjetore për Vendet e Ballkanit në Shqipëri, në vitin 2009, dhe bashkëpunimi me Agjencinë Ndërkombëtare ISBN ka vazhduar frytdhënës deri në momentin që e kanë lejuar ta ushtrojë këtë detyrë. Po ashtu, ajo citon se detyrën e "specialistes" pranë Agjencisë Kombëtare të ISBN e ka ushtruar me përkushtim të plotë.

Znj.G i është drejtuar Inspektoriatit të Punës, ku është ankuar në lidhje me ndryshimin në mënyrë të njëanshme të kushteve të kontratës së punës nga drejtorja e institucionit. Me shkresën e datës 27.03.2017 Inspektoriatit i Punës i referonte palëve në kontratë, pra znj.G dhe drejtores së Bibliotekës Kombëtare, të uleshin në bisedime për të arritur një marrëveshje lidhur me vazhdimin e kontratës së punës. Me datë 07.04.2017 znj.G ka paraqitur një kërkesë drejtores, znj.A për t'u ulur në bisedime rreth emërimit të saj si “klasifikatore”. Nëpërmjet e-mailit të datës 08.04.2017 Drejtorja i është përgjigjur negativisht, duke refuzuar në mënyrë të prerë bisedimet për ndryshimin e kushteve të kontratës së mëparshme.

Subjekti ankues parashtrimet për paligjshmëri të Urdhërit “Për emërim në detyrë”, me nr.132 prot., datë 15.02.2017 të drejtores së Bibliotekës Kombëtare i ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor.

Lidhur me sa më sipër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.9787, datë 21.11.2017 ka çmuar se drejtorja e Bibliotekës Kombëtare ka zgjidhur kontratën e punës pa shkaqe të justifikuara, pa respektuar afatin e njoftimit, si dhe procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës. Pra, Gjykata ka vlerësuar se në këtë rast nuk jemi në kushtet e lëvizjes paralele, siç pretendon Biblioteka Kombëtare, por në kushtet e zgjidhjes së kontratës së punës me ankuesen.

Për gjithë sa më sipër, ankuesja kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit nga ana e drejtores të Bibliotekës Kombëtare Tiranë, si dhe rivendosjen në vend të së drejtës të saj për rikthim në pozicionin e mëparshëm të punës, si specialiste pranë Sektorit të Agjencisë Kombëtare të ISBN-së.

Ankesa e sjellë pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me shpjegimet e dhëna prej subjektit ankues, në lidhje me shkaqet e pretenduara prej saj.

- Për këtë arsye, me shkresën me nr.661/1 prot., datë 27.06.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ka kërkuar ankueses të paraqesë dokumentet provues për pretendimin e saj, (lidhur me shkaqet e pretenduara), meqenëse ankuesja nuk i ka bashkëngjitur ankesës dokumentet shkresore që t'i provojë ato dhe as ka parashtruar argumentime lidhur me këtë fakt. Përsa më lart, ankuesja me shkresën me nr.66/2 prot., datë 09.08.2017 ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar.

Neni 91, pika 3 e Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar, parashikon se: *“Nëse ligji parashikon detyrimin e palës për të paraqitur dokumente ose prova, si pjesë ose së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës, afatet e përcaktuara sipas pikave 1 ose 2, të këtij neni, fillojnë nga paraqitja e plotë e tyre”.*

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen*

shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.661/3 prot, datë 14.08.2017 të Komisionerit i është kërkuar informacion drejtores së Bibliotekës Kombëtare, lidhur me pretendimin e znj.G.

Me shkresën me nr.152/4 prot., datë 13.09.2017 drejtorja e Bibliotekës Kombëtare solli para Komisionerit parashtrimet e veta lidhur me pretendimin e ankueses.

2. Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, me datë 17.11.2017², Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një seancë dëgjimore në ambjentet e Zyrës së Komisionerit.

Biblioteka Kombëtare u përfaqësua në seancë nga juristja e këtij institucioni znj.M. M³, ndërsa ankuesja u paraqit personalisht. Pretendimet e palëve janë pasqyruar në procesverbalin e mbajtur gjatë seancës.

III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vëren se:

A. Lidhur me pretendimin e ankueses se është trajtuar në mënyrë të pafavorshme, të padrejtë dhe të pabarabartë nga ana e drejtores së Bibliotekës Kombëtare.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të*

² Referuar njoftimit për seancën dëgjimore me nr.1080 prot., datë 02.11.2017, të Komisionerit.

³ Me autorizimin nr.152/16 prot., datë 07.11.2017 të drejtores së Bibliotekës Kombëtare.

përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Me Urdhërin nr.132 prot., datë 15.02.2017, "Per emërim në detyrë", të drejtores së Bibliotekës Kombëtare znj.G është emëruar në pozicionin e punës "klasifikatore", pranë Sektorit të Katalogimit Retrospektiv Elektronik. Këtë emërim punëdhënësi e ka bërë me argumentimin se ankuesja ka rritur në mënyrë të ndjeshme marrjen e raporteve mjekësore dhe se konkretisht citohet se, për vitin 2016 ajo rezulton të ketë 61 ditë pune me raport, ndërkohë për vitin 2017, gjatë një periudhe kohe rreth 8 mujore znj.G rezulton të jetë me raport mjekësor të pagueshëm nga punëdhënësi dhe Sigurimet Shoqërore.

Mirëpo, nga këqyrja dhe verifikimi që Komisioneri u ka bërë raporteve mjekësore të depozituara nga palët dhe periudhave kohore kur janë marrë, rezulton se:

- Përgjatë vitit 2016 ankuesja ka paraqitur raporte mjekësore në periudhat kohore, specifikisht si më poshtë cituar:
- 29.12.2015-12.01.2016 (14 ditë), 12.01.2016-15.01.2016 (3 ditë), 30.03.2016-02.04.2016 (3 ditë), 23.06.2016-25.06.2016 (2 ditë), 27.06.2016-30.06.2016 (3 ditë), 02.08.2016-06.08.2016 (4 ditë), 17.08.2016-20.08.2016 (3 ditë), 11.10.2016-15.10.2016 (4 ditë), 14.11.2016-10.12.2016 (26 ditë), 10.12.2016-09.01.2017 (30 ditë).
- Përgjatë vitit 2017 ankuesja nuk ka qenë në punë, pasi ka qenë me raport mjekësor për periudhat kohore si mëposhtë cituar:
- 15.02.2017-18.02.2017 (3 ditë), 21.02.2017-25.02.2017 (4 ditë), 28.02.2017-07.03.2017 (7 ditë), 07.03.2017-14.03.2017 (7 ditë), 14.03.2017-29.03.2017 (15 ditë), 29.03.2017-13.04.2017 (15 ditë), 14.04.2017-29.04.2017 (15 ditë), 29.04.2017-14.05.2017 (15 ditë), 14.05.2017-13.06.2017 (30 ditë), 13.06.2017-13.07.2017 (30 ditë), 13.07.2017-12.08.2017 (30 ditë), 12.08.2017-01.09.2017 (20 ditë).
- Nga sa më lart pasqyrohet, Komisioneri thekson se, **deri në momentin e emërimit të ankuses në pozicionin klasifikatore, me datë 15.02.2017, ajo kishte munguar në punë, me raport mjekësor për 9(nëntë) ditë, sa i takon vitit 2017(referuar raportit mjekësor me nr.regjistri 216, datë 10.12.2016 "Raport për paaftësi të përkohëshme në**

punë nga sëmundje të përgjithshme që paguhen nga sigurimet shoqërore”, lëshuar nga Komisioni Mjeko-Ligjor).

- Ndërsa, përsa i përket periudhës **gjatë vitit 2016-15 Shkurt 2017, datë kur u bë emërimi i znj.G si klasifikatore, kishte munguar në punë, me raporte mjekësore, në periudha të ndryshme kohore, për rreth 80 ditë gjithsej.**
- Pra, në këtë kontekst, **justifikimi i drejtores se kalimi i ankueses në pozicionin klasifikatore u bë si shkak i mungesave të saj të shumta, rreth 8 muaj nuk qëndron. Kjo, për arsyen se, vërtet në total për gjithë periudhën kohore nga Dhjetori 2015-1 Shtator 2017 ankuesja rezulton të ketë munguar në punë, justifikuar me raportet mjekësore sipërcituar, (282 ditët në total, gjatë viteve 2015-2017), por pjesa më e madhe e këtyre ditëve i përket periudhës pasi ajo kishte kaluar në pozicionin e ri si klasifikatore, pas datës 15 shkurt 2017. Konkretisht, rreth 200 ditë i përkasin periudhës pas 15 Shkurtit 2017-1 Shtator 2017.**

Gjatë periudhës që ankuesja znj.G nuk mund të ushtronte detyrat e saj, kjo justifikuar edhe me raportin mjekësor, Biblioteka Kombëtare ka caktuar punonjësen V. S si punonjësen e cila do të zëvendësonte në kryerjen e detyrave ankuesen znj.G.

Komisioneri gjen të pabazuar ligjërisht arsyetimin e Bibliotekës Kombëtare se:

- ka vlerësuar pozicionin "klasifikatore" pranë Sektorit të Katalogimit Retrospektiv Elektronik, si të përshtatshëm për realizimin e detyrave nga ana e znj.G, pasi ka shkollimin përkatës për këtë pozicion,
- dhe se realizimi i lëvizjes paralele, pra emërimi i saj në një pozicion pune me të njëjtën kategori page (Kategoria IV-a) konkretisht në pozicionin "klasifikatore" pranë Sektorit të Katalogimit Retrospektiv Elektronik, nuk është ndryshim i kushteve të kontratës së mëparëshme po vazhdim i saj.

Lidhur me sa sipërcituar, **Komisioneri vlerëson se kalimi i ankueses nga pozicioni i punës "specialist", kategoria IV-a, në atë të "klasifikatores" pranë Sektorit të Katalogimit Retrospektiv Elektronik në Bibliotekën Kombëtare Tiranë, është në fakt ndërprerje e kontratës së parë të punës dhe fillim i një kontrate të re pune, pavarësisht se ka vijuar vazhdimësia e marrëdhënies kontraktore të punës mes punëdhënësit dhe punëmarrësit në aspektin financiar, dhe pavarësisht se elementi pagë mbetet i njëjtë.**

Biblioteka Kombëtare ka lidhur dy kontrata me ankuesen dhe për të kaluar nga një pozicion tek tjetëri, ankuesja ka zgjidhur kontratën për pozicionin e punës specialiste dhe mandej ka lidhur kontratën për pozicionin e punës së klasifikatores. Ky fakt, është pranuar nga të dyja palët.

Pas analizimit të pretendimeve, parashtrimeve të palëve në proces dhe të dokumentacionit, të shqyrtuar, **Komisioneri konstaton se pozicioni i punës “specialist” pranë Sektorit të Agjencisë Kombëtare të ISBN-së me pozicionin “klasifikatore” pranë Sektorit të Katalogimit Retrospektiv Elektronik janë dy pozicione të ndryshme, sipas përcaktimeve që specifikohen në “Organikën e Bibliotekës Kombëtare” miratuar me shkresën me nr.1305/1 prot., datë 28.03.2014.**

Nga ana tjetër, konstatojmë se, ankuesja ka depozituar raportet mjekësore konform parashikimeve ligjore pranë punëdhënësit të cilat i janë paguar rregullisht (nga punëdhënësi apo Sigurimet Shoqërore, sipas përcaktime ligjore të parashikuara specifikisht). **Fakti i ligjshmërisë së raporteve mjekësore nuk është kundërshtuar nga punëdhënësi dhe për sa kohë ai është njohur me këtë fakt, është kompetencë dhe detyrim i punëdhënësit të zgjidhë problematikën e krijuar me mungesën e justifikuar të znj.G, përmes delegimit apo zëvendësimit të përkohshëm, deri në daljen në punë të saj, pas përfundimit të raporteve mjekësore.**

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet t gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Kushtetuta e Shqipërisë në nenin 18 të saj ka sanksionuar se: *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht...nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.”*

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore. Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi.

Në këtë kuadër, në **“Kartën Sociale Europiane”** të rishikuar⁴, dhe shtojcën e saj, në nenin **24, pika 3, germa f)** parashikohet se: *“...Nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit:.. f) mungesa e përkohshme në punë për shkak sëmundjeje ose dëmtimi”*.

Parimi i ndalimit të diskriminimit në fushën e punësimit përshkon në tërësi nenin 9 të Kodit të Punës, të ndryshuar, i cili përcakton se: *“Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët”*.

Kjo është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së⁵. Ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Gjithashtu në nenin 12, pika 1, germa b) parashikon se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

⁴ “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr.8960, datë 24.10.2002.

⁵ Referuar nenit 3, pika 8 ,e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se znj.G i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë, krahasuar me parashikimet e legjislacionit të brendshëm, kombëtar dhe atij ndërkombëtar.

B. Lidhur me shkakun e pretenduar nga ankuesja si shkak të sjelljes diskriminuese ndaj saj nga ana e Bibliotekës Kombëtare.

Për të vërtetuar se ndaj ankueses ka një sjellje diskriminuese nga ana e Bibliotekës Kombëtare duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”⁶ dhe trajtimit të pafavorshëm të ankueses.

Komisioneri ka argumentuar qëndrimin e tij, lidhur me shkaqet për të cilat ka krijuar bindjen se ankuesja ka arritur t’i provojë.

➤ **Pretendimi i znj.G se shkak për diskriminim ndaj saj është bërë gjendja shëndetësore, përbën një shkak që gëzon mbrojtje sipas nenit 1 të ligjit.**

- a) Nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara nga Komisioneri, rezulton se punëdhënësi ishte në dijeni të raporteve mjekësore të ankueses⁷, në të cilat citohet paaftësia fizike e përkohshme në punë.
- b) Kopje të raporteve mjekësore janë depozituar në dosjen e ankueses. Po ashtu, janë depozituar në cilësi prove sms dhe e-maile të ankueses që provojnë njoftimin e titullarit apo personit përgjegjës të institucionit lidhur me mungesën e saj në punë, justifikuar me raportet mjekësore.
- c) Me Urdhërin nr.132 prot., datë 15.02.2017, drejtorja e Bibliotekës Kombëtare ka emëruar znj.G në pozicionin “klasifikatore” pranë Sektorit të Katalogimit Retrospektiv Elektronik, pozicion i ndryshëm nga ai që mbante deri në atë moment si “specialiste” pranë Sektorit të Agjencisë Kombëtare të ISBN-së.

⁶ Në interpretim të nenit 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

⁷ Raportet janë cituar gjatë vendimit dhe janë depozituar në institucion nga ankuesja.

c) Është e pranuar nga ana e Bibliotekës Kombëtare se arsyeja e këtij ndryshimi pozicioni ka ardhur si rezultat i mungesës së zgjatur të ankueses, justifikuar me raporte mjekësore.

Pra, si shkak për emërimin në pozicionin e ri të punës ka shërbyer gjendja shëndetësore e ankueses.

d) Pretendimit të ankueses se znj.B është më pak e kualifikuar se ajo për pozicionin e punës që e kishte zëvendësuar, Biblioteka Kombëtare iu përgjigj në mënyrë të përgjithshme dhe pa ndonjë provë të dokumentuar në mënyrë që të mund të rrëzonte pretendimin e znj.G.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Bibliotekës Kombëtare.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

Për sa më sipër, Komisioneri gjen të provuar dhe të mbështetur në argumente bindëse dhe në ligj, se shkak i gjendjes shëndetësore sipërcituar ka çuar në trajtimin e pafavorshëm, të padrejtë dhe të paligjshëm të znj.G, nga ana e punëdhënësit, Bibliotekës Kombëtare, gjë që ka çuar në diskriminim të saj.

➤ **Lidhur me pretendimin e ankueses se shkak për diskriminim ndaj saj është “çdo shkak tjetër”.**

Neni 1, i ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh⁸, çka është në të njëjtën linjë me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe

⁸ Neni 1, i ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”*

Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh⁹.

Referuar praktikës së GJEDNJ-së, ajo ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statute të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. Ky arsyetim mund të na shërbejë për analogji edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “me çdo shkak tjetër”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

- e) Në këtë kontekst, ankuesja me “çdo shkak tjetër” ka argumentuar se ndryshimi i pozicionit të saj të punës në “klasifikatore” ka ardhur si rezultat i favorizimeve që drejtorja e Bibliotekës Kombëtare i ka bërë punonjëses që ka zëvendësuar atë në pozicionin “specialiste” pranë Sektorit të Agjencisë Kombëtare të ISBN-së, znj.M. B(T). Lidhur me këtë fakt, ankuesja pretendon se znj.B është e bija e një prej figurave të njohura të Partisë Socialiste, z.F. T, i cili njëkohësisht është dhe pronari i shtëpisë botuese “Toena”. Ky pretendim nuk është rrëzuar nga ana e punëdhënësit, Bibliotekës Kombëtare. Madje nuk është paraqitur asnjë argument për të kundërshtuar pretendimin e ankueses se emërimi i saj në këtë pozicion pune e vë atë në konflikt të hapur interesi, për shkak të lidhjeve familjare me pronarin e një shtëpie botuese në vend. Duke patur parasysh që specialist i ISBN-së vihet në dijeni të shumë të dhënave në lidhje me shtëpitë botuese në vend, dhe duke patur lidhje familjare me botuesin, në rastin specifik, kjo do të çonte drejt një konkurrence të pandershme.
- f) Lidhur me këtë pretendim të ankueses, znj.D. A/Kryetare e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit, ka depozituar një deklarinim përpara Komisionerit¹⁰. Znj.A shprehet se ka biseduar me drejtoreshën e Bibliotekës Kombëtare për çështjen e znj.G. Ajo thekson se znj.A gjatë bisedës i ka pohuar se ka emëruar znj.B në vend të znj.G, pasi në atë moment znj.B po kalonte ca probleme familjare dhe ishte e ngarkuar emocionalisht dhe se për të kishte ndërhyrë z.F.T, i cili ishte deputet i Kuvendit të Shqipërisë.

⁹ Neni 14, i KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

¹⁰ Referuar procesverbalit të mbajtur me znj.Drita Avdyli në Zyrën e KMD-së, me datë 01.08.2017.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se trajtimi i pafavorshëm dhe i pabarabartë i znj.Ga nga ana e drejtores së Bibliotekës Kombëtare, duhet të ketë si bazë karakteristikën personale të ankueses, që e bën të dallueshme nga personi tjetër me të cilin krahasohet. Gjithë sa ankuesja pretendon për sa më lart, janë cilësi personale të znj.B dhe jo të ankueses.

“ Çdo shkak tjetër” nuk është shkak më vehte. Parë në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se pretendimi i ankueses se faktet e mësipërme mund të cilësohen tek “çdo shkak tjetër” nuk qëndron.

PËR KËTO ARSYE :

Në bazë të nenit 12, pika 1, germa c), nenit 32, gërma c), si dhe nenit 33, pikat 10, 11, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I .:

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë, të znj.E. G, nga ana e punëdhënësit, Biblioteka Kombëtare, për shkak të “gjendjes shëndetësore”.
2. Në referim të pikës 1, Biblioteka Kombëtare, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese ndaj znj.G, të bëjë rikthimin e saj në vendin e mëparshëm të punës si “specialiste” pranë Sektorit të Agjencisë Kombëtare të ISBN-së.
3. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Biblioteka Kombëtare, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.

4. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

(shkaku: gjendja shëndetësore)
(fusha: punësim)